



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 49, datë 11.11.2015

**Për**

**“MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRCAKTIMIT TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE NËNZONAVE TË DESTINUARA PËR PARKIM, SI DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT TË ADMINISTRUARA NGA BASHKIA E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/I, shkronja “b”, nenit 8, pika 1/III, shkronja “b”, nenit 16 pika 3, shkronja “a”, nenit 32, shkronja “f” dhe nenit 33, pika 3 të Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 7, pika 1, shkronjat “e” dhe “f”, pikat 8, 10 e 11 të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar); nenit 121 pika 1, 124 pika 1 dhe nenit 125 të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar); nenit 35 pika 2 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 19.06.2006 “Për miratimin e projektit për një sistem të ri parkimi për Tiranën”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë kriteret për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit në Bashkinë e Tiranës dhe nënzonave të destinuara për parkim sipas Aneksit 1 bashkëlidhur.
2. Të miratojë zonat e administrimit të parkimit në qytetin e Tiranës dhe respektivisht nënzonat e destinuar për parkim sipas Aneksit 2 bashkëlidhur, për të vendosur Tirana Parking në kushte pune.
3. Në mbështetje të pikës 1 ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës të vlerësojë plotësimin e kushteve për shtrirjen e zonave të administrimit të parkimit (“ZAP”) në Bashkinë Tiranë dhe respektivisht të ndjekë procedurat për plotësimin, përmirësimin ose shtimin e nënzonave të destinuara për parkim (“NDP”) duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në Aneksin 1.
4. Në mbështetje të pikës 1 ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës të rishikojë dhe përcaktojë një ndarje të re të zonave të administrimit të parkimit (“ZAP”) dhe respektivisht nënzonat e destinuara për parkim (“NDP”) nëse nuk përputhen me planet e transportit e qarkullimit.
5. Të përcaktojë tarifën e shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës sipas Aneksit 3 bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Pika 1/1.2, shkronja”c”,*“Tarifën e Parkimit të Automjeteve”* e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 05.02.2007 *“Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”* (i ndryshuar) dhe Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 03.02.2003, *“Mbi caktimin e vendparkimeve publike me pagese ne qytetin e Tiranës”* (i ndryshuar) shfuqizohen.
7. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 2, datë 30.01.2006 *“Për përcaktimin e vendndodhjes së parkimeve me pagesë për shërbimin taksi (4+1), (8+1) dhe të mjeteve për transport të mallrave për të tretë në qytetin e Tiranës”* shfuqizohet.
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë dhe Tirana Parking.
9. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**ALDRIN DALIPI**